

Arrestohet një 54 vjeçar për kërcënim dhe armëmbajtje pa leje

LAJME



08/05/2023 08:44



Policia e Kosovës ka arrestuar një 54 vjeçar në fshatin Vatë të Kaçanikut.

Arrestimi i tij ka ndodhur pasi që i njëjti dyshohet se ka kërcënuar një preson tjetër të moshës 47 vjeçare.

Atij iu gjet edhe një armë pa leje.

“Policët e rendit dhe policët hetues nën autorizim të prokurorit kujdestar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj kanë shkuar në fshatin Vatë dhe kanë arrestuar të dyshuarin, i cili shkak i një mosmarrëveshje kishte kanosur me armë personin tjetër, ndërsa më pas policia nga i dyshuari ka konfiskuar armën e zjarrit (pistoletë) me 12 fishekë dhe një thikë”, thuhet në njoftim.



Po ashtu është bërë e ditur se i dyshuari është shoqëruar në stacionin e policisë në Kaçanik dhe pas intervistimit nga policët hetues, me vendim të prokurorit është ndaluar në mbajtje për 48 orë, ndërsa rasti është cilësuar “ Armëmbajtje pa leje dhe kanosje”.[/Lajmi.net/](#)

Artikuj të ngjashëm



May 8, 2023

Ekspertët paralajmërojnë se vendi mund të varfërohet edhe më tepër, kërkojnë...



May 8, 2023

Parashikimi i motit për sot



May 8, 2023

Kryetari i Parlamentit të Austrisë me vizitë në Kosovë



May 7, 2023

Politikania serbe: Kosova u solidarizua me ne për tragjeditë, turp Vuçiqit...



May 8, 2023

Lajçak: Drafti i Ekipit Menaxhues, pikënisje për diskutimet e ardhshme



May 7, 2023

Kurorëzimi i Mbretit Charles III u shikua nga më shumë se 18 milionë shikues

LAJME TË FUNDIT




Kartona të kuq me 'bollëk', derbi argjentinasi takoi River Plate



Ekspertët paralajmërojnë se vendi mund të varfërohet edhe...



Arteta s'dorëzohet për titull



Man United – De Gea, afër marrëveshjes